



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
DREJTORIA E HARTIMIT TË AKTEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE  
SEKTORI I HARTIMIT TË AKTEVE DHE PËRPUTHSHMËRISË

Nr. 341/4 Prof.

Tiranë, më 01.09.2025

URDHËR

Nr. 15/2 datë 01.09 2025

“PËR

**DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 15, DATË 11.02.2025, TË INSPEKTORIT  
TË LARTË TË DREJTËSISË “PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR  
MONITORIMIN E SJELLJES SË NËPUNËSVE CIVILË GJATË PROCESIT  
ZGJEDHOR”**

Në zbatim të nenit 204, të pikës 1, të germës “c”, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 5 dhe 37 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, të vendimit nr. 9, datë 26.12.2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

URDHËROJ:

1. Në pikën 1, të urdhrit nr. 15, datë 11.02.2025, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor”, bëhet ndryshimi si vijon:

“1.Ngritjen e Grupit të Punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore me këtë përbërje:

- Znj. Zonje Shelqizi, Specialist (Burime Njerëzore) në Sektorin e Burimeve Njerëzore - Kryetar.
- Z. Nertil Kanina, Ndhmës Inspektor, Njësia e Ndhmës Inspektorëve - Anëtar.

- Znj. Blerta Kërçuku, Specialist në Sektorin e Hartimit të Akteve dhe Përputhshmërisë- Anëtar.”
2. Në pikën 2, të urdhrit nr. 15, datë 11.02.2025, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor”, bëhet ndryshimi si vijon:  
  
“2.Koordinatori i grupit që do të komunikojë me palët e interesuara në këtë proces dhe me Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil do të jetë znj. Zonje Shelqizi Specialist (Burime Njerëzore) në Sektorin e Burimeve Njerëzore.”
  3. Ngarkohen nëpunësit civilë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me zbatimin e këtij urdhri.
  4. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin dhe publikimin e këtij urdhri, në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

**Artur Metani**

